

RELACION

TEKNIK

PER PROJEKT ZBATIMI PER OBJEKTIN:

Asfaltimi i disa akseve rrugore ne Bashkine Vlore

Projekt – zbatimi bashkangjitur, konsiston në zgjidhjen optimale për sistemimin e rrugëve në disa nga akset e rrugëve në Bashkinë Vlorë

- Rruga Hamza Isai
- Rruga Risili (rruga e varrezave)
- Rruga në brendësi të varrezave Vlorë

Rrugët janë ekzistuese me të gjitha nënshtresa por me dëmtime ose mungesë në disa pjesë të shtresave asfaltike. Ky si rezultat i mos mirëmbajtjes për një periudhe të gjatë kohore.

Përgjatë tyre ka kanale ekzistuese ose sipërfaqe shkarkimi të ujërave sipërfaqësor.

Pas studimit të gjendjes aktuale si dhe rilevimit topografik nga ana topografëve të Bashkisë Vlorë është realizuar projekti nga ana Drejtorisë së Urbanistikës Bashkisë Vlorë

SHTRESAT RRUGORE

Në funksion të trafikut, bazamentet ku kalojnë rruga dhe materialeve të ndërtimit që do të përdoren, janë përcaktuar shtresat e rrugës për secilin segment rrugor, të cilat po i përcaktojmë më poshtë:

- Rruga Hamza Isai

Shtresë asfaltobetoni 4 cm

- Rruga Risili (rruga e varrezave)

Shtresë asfaltobetoni 4 cm

- Rruga në brendësi të varrezave Vlorë

Shtresë asfaltobetoni 4 cm

Shtresë binderi 6 cm

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për rikonstrukcionin e rrugës është parashikuar që materialet e ndërtimit do të prodhohen me gurë kave që gjendet në guroret e rrethit . Materiali i asfalto betonit do të vijë i gatshëm nga nyjet më të afërta në përputhje me kërkesat e projektit

Të gjitha punimet janë parashikuar të kryhen në përputhje me specifikimet teknike që i bashkëngjiten këtij projekti.

Preventivi i punimeve është dhënë për të gjithë rrugën .

Në preventiv janë parashikuar të gjithë zërat e punimeve sipas specifikimeve teknike të këtij projekti, çmimet janë marrë nga Manuali i teknike të ndërtimit, VKM NR. 629 dt. 15.07.2015.

Për të gjitha zërat e punimeve janë bërë analizat e prodhimit dhe vendosjes në vepër në përputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike në fuqi.

Bashkëngjitur këtij raporti janë dhënë; specifikimet teknike të punimeve, volumet e punimeve me vlerësimet e kostos, dhe preventivi përkatës

Në preventivin e punimeve parashikohet punime të domosdoshme për riaktivizimin dhe rikonstruksionin të ndonjë segmenti të mundshëm që do të rezultojë i dëmtuar dhe jashtë funksionimit. Punime këto që duhet të konfirmohen mbas verifikimit nga ekipi i specializuar i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike .

Situacionimi i këtyre punimeve do të bëhen mbas verifikimit dhe matjes së punimit në proces verbalin e vecantë që do të hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe drejtuesi teknik i punimeve.

Ing. Darjan HUDHRA